




**SINDIKATA E PAVARUR
E DOGANËS SË KOSOVËS**



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

SINDIKATËS SË PAVARUR TË DOGANËS SË KOSOVËS

DHE

KOLEGJIT PJETËR BUDI

Prishtinë, Janar 2024



Palët nënshkruese

1. SINDIKATA E PAVARUR E DOGANËS SË KOSOVËS - (SPDK), adresa: Drejtoria e Doganës, Rr. “Rexhep Krasniqi”, 10000 Prishtinë, të cilën e përfaqëson Kryetari zt. **Ali Vitija**,

2. Kolegji “PJETËR BUDI” – (KPB), adresa: Gazmend Zajmi, nr.103 (Aktashi I) 10000 Prishtinë, të cilin e përfaqëson Rektori i Kolegjit “Pjetër Budi”, **Prof.ass.dr. Sabri Klaiqi**: Në tekstin e mëtejme: “Palët”

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandum Bashkëpunimit në mes të Sindikatës së Pavarur të Doganës së Kosovës (në tekstin në vijim SPDK) dhe Kolegjit Pjetër Budi, (KPB), është bashkëpunimi i ndërsjellët për shkëmbimin e personelit akademik/profesional (deficitar) në fusha të caktuara, bashkëpunime në konferenca, trajnime, salla dhe mbajtjen e praktikës profesionale të studentëve të Kolegjit Pjetër Budi.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit dhe zotimet

1. Kolegji Pjetër Budi, zotohet ta mbështesë SPDK me ofrimin e zbritjeve speciale, në tarifatat e shkollimit, për anëtarët e SPDK -së me zbritje prej **50% (me kusht që nota mesatare të mbahet (9))** nëntë, kurse familjarët (bashkëshorti/bashkëshortja dhe fëmijët e tyre) zbritje prej 35%, në nivelin Bachelor.



2. Kolegji Pjetër Budi, zotohet të ofroj bursë të plotë studimi **për çdo të dhjetin student** (për anëtarët e SPDK -së ose familjarë i tyre) **nga Dogana e Kosovës, në nivelin Bachelor,**
3. Sindikata e Pavarur e Doganës së Kosovës dhe Kolegji Pjetër Budi do të shkëmbejnë përvojat dhe praktikat më të mira mes veti, si: mbajtjen e ligjëratave semestrale nga ekspertët e anëtarëve të Sindikatës së Pavarur të Doganës së Kosovës në KPB dhe anasjelltas, ofrimin e sallave të ligjërimit për trajnime në KPB, bashkëpunim në konferenca, trajnime të ndryshme profesionale, punëtori, seminare të ndryshme kombëtare apo ndërkombëtare dhe mbajtjen e praktikës profesionale të studentëve të KPB në Doganën e Kosovës.
4. Në planprogramin e Kolegjit “Pjetër Budi” të inkorporohen edhe lëndë të reja që kanë të bëjnë me organizimin sindikal dhe benefitet e të qenurit anëtarë, për të siguruar mirëqenien e shoqërisë.
5. Anëtarët e SPDK -së për përfitimin e këtyre zbritjeve duhet të posedojnë kartelën e zyrtarit doganor, ndërsa fëmijët e tyre duhet të posedojnë një kopje të certifikatës së lindjes dhe një kopje të kartelës së zyrtarit doganor/prindit.
6. Sipas nevojës, anëtarët e SPDK -së dhe Kolegji Pjetër Budi zotohen të mbajnë kontakte të vazhdueshme për shkëmbim informacionesh dhe të dhënash me qëllim të mbarëvajtjes së bashkëpunimit dhe zbatimit të këtij Memorandumi.
7. Të gjithë anëtarët e SPDK -së dhe fëmijët e tyre do të trajtohen me respekt të lartë gjatë marrjes së shërbimeve nga nënpunësit e kolegjit, të cilët kanë shprehur gatishmërinë për të ofruar zbritje.



Neni 3

Pikat e kontaktit

1. Me qëllim të implementimit/zbatimit të këtij Memorandumi, pika të kontaktit për bashkërendim mes Palëve nënshkruese do të jenë:

1.1. Për Sindikatën e Pavarur të Doganës së Kosovës – Zyra e SPDK

1.2. Për Kolegjin Pjetër Budi – Zyra e Sekretarit të Kolegjit “Pjetër Budi”.

Neni 4

Ndryshimi dhe ndërprerja e Memorandumit

Ndryshimi, plotësimi dhe ndërprerja e këtij Memorandumi mund të bëhet vetëm me miratimin e Palëve nënshkruese dhe me njoftimin me shkrim në afat prej tridhjetë ditësh nga Palët nënshkruese.

Neni 5

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Në rast të mosmarrëveshjeve Palët do të caktojnë një ekip punues për evitimin e mosmarrëveshjeve, dhe në rast të dështimit të përpjekjeve, secila Palë ka të drejtë të tërhiqet nga ky Memorandum, duke paralajmëruar me shkrim 60 ditë përpara.



Neni 6

Kopjet e Memorandumit

Ky Memorandum nënshkruhet në dy kopje origjinale, nga një kopje për secilën Palë.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe vlenë për një periudhë të pacaktuar kohore.

PALËT NËNSHKRUESE

Nënshkruar me datë, 10/01/2024

Kryetari i SPDK z. Ali Vitija

Sindikata e Pavarur e Doganës së Kosovës



Prof. Ass.Dr. Sabri Klaiqi

Rektor i Kolegjit Pjeter Budi